



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:071910
Datë: 22.06.2022
Numri i dokumentit: 03159556

C.nr.475/2021

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëseve I. M., M. K. dhe Gj. Xh, që të gjithë me vendbanim në Gjakovë, të cilat me autorizim i përfaqëson i autorizuari Ilir Rogova, – avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit € , pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur në prezencën e të autorizuarit të paditëseve dhe në prezencë të autorizuarit të paditurës me datë 08 qershor 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit I. M., nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit I. M., nga Gjakova, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga data 03.09.2018 e deri me datën 11.03.2020, për 260 ditë të pranisë në punë, të i'a paguajë shumën prej 520,00€, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga paraqitja e padisë datë 14.04.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbaramit të detyrueshëm.

II.APROVOHET si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses Gj. Xh., nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses Gj. Xh. nga Gjakova, nga Gjakova, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore prej datës 15.04.2018 e deri me datë 09.03.2019, për 172 ditë të pranisë në punë, të i'a paguajë shumën prej 344,00€, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga paraqitja e padisë datë 14.04.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbaramit të detyrueshëm.

III. Padia e paditëses M. K., nga Gjakova, e ushtuar kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, në këtë çështje juridike civile, konstatohet e tërhequr.

IV.DETYROHET e paditura që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësve të i'a paguajë shumën prej 591.60€, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit I. M., M. K. dhe Gj.Xh., që të gjitha me vendbanim në Gjakovë, në këtë gjykatë, me datën 14.04.2021, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit. I autorizuari i paditësve në seancën e datë 12.05.2022, ka bërë tërheqjen e padisë ndaj paditëses së dytë M. K., si dhe ndaj kërkesës së paditëses Gj. Xh. për periudhën kohore nga data 19.04.2017 deri me 14.04.2018. I autorizuari i paditëseve, në parashtrësën e datës 16.05.2022, ka bërë precizimin e kërkesë padisë në aspektin objektiv. I njëjti në padinë e precizuar, fjalën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesorë të çështjes, dhe në fjalën tij përfundimtarë ka deklaruar se paditësi i parë është në marrëdhënie punë të e paditura përkatësisht në shkollën "P. J." në Gjakovë, dhe i njëjti për periudhën kohore nga data 03.09.2018-11.03.2020 ka vijuar 260 ditë të pranisë në punë, ndërsa paditësja Gj. Xh. ka qenë në marrëdhënie punë në shkollën "K. K.", në Gjakovë dhe e njëjta për periudhën kohore ka 15.04.2018-09.03.2019 ka vijuar 172 ditë të pranisë në punë. Objekti i këtij kontesti ka të bëjë me kompensimin e parave të ushqimit, obligim ky që për të paditurën buron nga Kontrata kolektive e vitit 2017 dhe ajo e vitit 2021. I njëjti ka deklaruar se fakti se paditëset edhe më herët për periudhë tjetër kohore i kanë realizuar suksesshëm parat e shujtës, pikërisht përmes kontestit gjyqësor para kësaj periudhe, prandaj të njëjtat kanë pritje legjitime se do të kompensohen sërish për pjesën e pa realizuar. Andaj mbi këtë bazë i ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadija e precizuar e paditëseve të aprovohet si e bazuar, ashtu që të detyrohet e paditura që paditësit të parë për 260 ditë të pranisë në punë të realizuara të ia paguaj shumën prej 520.00 euro dhe paditëses së tretë për 172 ditë të pranisë në punë, të ia paguaj shumën prej 344,00 euro, me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe të njëjtat i ka specifikuar dhe atë: atë për taksë gjyqësore 30,00 €, për përpilimin e padisë shumën prej 156,00 € dhe për pjesëmarrjen në dy seanca shumë prej 405.60(2x 202.80), shumën e përgjithshme prej 591.60 euro.

E paditura me përgjigje në padi të parashtruar në gjykatë me datën 08.12.2020 e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, dhe dukë i propozuar gjykatë që të merr aktgjykim dhe të njëjtën ta refuzojë si të pabazuar. Me te ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar dhe ka propozuar që kërkesëpadija e paditëses të refuzohet. Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të nënshkruar me datë 18 prill 2017 në mes të Arsim Bajrami ish Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Rrahman Jashari, Kryetar i SBASHK-ut njoftojnë se përkundër nenit 46 të asaj Kontrate, nga ana e MASHT-it dhe SBASHK-ut nuk janë angazhuar dhe ndihmuar Komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e asaj Kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit. Ka kërkuar që të detyrohet paditësja që të paditurës të ia kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në kuptim të nenit 452 të LPK-së.

I autorizuari i të paditurës, në fjalën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesorë të çështjes dhe në fjalën tij përfundimtare ka deklaruar se Kontrata Kolektive e Arsimit e nënshkruar në mes të MASHT-it të dt. 22.01.2021 në nenin 47 të saj, ka shfuqizuar kontratën kolektive të dt. 18.04.2017, ashtu që sipas nenit 35 par. 7 të kësaj kontrate si dhe lidhur me këtë dhe dispozitat kalimtare të nenin 45 par. 1 nuk është bërë kurrfarë ndihmese në planifikimin e buxhetit për realizimin e kërkesave lidhur me zbatimin e dispozitave të nenit 35 par. 7 deri sa të krijohen mundësit financiare në Buxhetin e R. Kosovës por jo ma vonë se viti 2023, po ashtu edhe sipas Qarkores Buxhetore 2022/01 i dt. 14.05.2021, te granti specifik të arsimit para universitar, ka deklaruar se nuk është paraparë mundësia për realizimin e kësaj të drejte. Andaj mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar. Ndërsa lidhur precizimin e bërë me datën 16.05.2022, i njëjti ka deklaruar se nuk e kundërshtojmë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në seancën shqyrtimit kryesor-publik i administroi këto prova: Kontrata e punës, për paditësin Ideal Meka e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me nr. leg. Nr.3384/2020 i dt 22.11.2020 si dhe Kontrata e Punës me nr. /..... e dt 22.12.2020; Vërtetimi i lëshuar nga Shkolla e Muzikës "P. J." - Gjakovë me Nr. të prot.../.. me dt. 31.01.2021; Kontrata e punës, për paditësen Gj.Xh. e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me nr. leg. Nr.../.. / i dt 05.01.2021; Vërtetimi i lëshuar nga SHMLE " K.K." - Gjakovë me nr të prot... i dt. 05.01.2021; Vërtetimi i lëshuar nga SHMLE " K. K." - Gjakovë me nr të prot.../.. i dt. 12.05.2022.

Pasi që Gjkata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore,(më tutje LPK-së), arriti në përfundim se në këtë çështje juridikë kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Kontrata e punës për paditësin I. M., gjykata vërtetoje faktin se paditësi, është e punësuar te e paditura, respektivisht në Shkollën "P. J.", në Gjakova, ndërsa nga vërtetimi me Nr.Prot.../.. i datës 13.01.2021 gjykata vërtetojë faktin se paditësi i lartpërmendur për periudhën kohore nga data 03.09.2018-11.03. ka vijuar 260 ditë të pranisë në punë.

Nga Kontrata e punës për paditësen Gj.Xh., gjykata vërtetoje faktin se paditësja, ka qenë e punësuar te e paditura, përkatësisht në shkollën "K. K." në Gjakovë deri ne pensionim, ku nga vërtetimi me Nr.Prot.../.. i datës 12.05.2022, gjykata vërtetojë faktin se paditësja e lartpërmendur për periudhën kohore nga data 15.04.2018-20.06.2018 e ka vijuar 48 ditë të pranisë në punë, ndërsa vërtetimi me Nr.prot... i datës 05.01.2021 vërtetojë faktin se paditësja nga data 01.09.2018-09.03.2019 ka vijuar 124 ditë punë, gjithsej 172 ditë të pranisë në punë.

Në neni 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës 01/B e cila ka hyrë në fuqi me datën 22.01.2021, në mënyrë identike parashihet se *"Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.*

Gjykata nga administrimi i provave të cilave prova dhe ja fali besimin e plot, gjeti se paditësi I. M., është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Shkollën “P. J.” në Gjakovë. I njëjti për periudhën kohore nga data 03.09.2018-11.03.2020 ka vijuar 260 ditë të pranisë në punë, fakt ky i vërtetuar sipas vërtetimit me Nrprot.../..., i datës 13.01.2021. Ndërsa paditësja Gj. Xh., ka qenë e punësuar në shkollën “K. K.” në Gjakovë, por që marrëdhënia e punës i është ndërprerë për shkak të pensionimit. E njëjta për periudhën kohore nga data 15.04.2018-20.06.2018 ka vijuar 48 ditë të pranisë në punë, rrethanë kjo të cilën gjykata e vërtetojë nga vërtetimi me Nr. prot. .../... i dt.12.05.2022, ndërsa nga data 01.09.2018—09.03.2019 ka vijuar 124, ditë të pranisë në punë, provuar sipas vërtetimit Nr.prot... i datës 5.01.2021. Andaj duke u nisur nga fakti se e paditura, paditësve nuk i’au ka paguar shpenzimet e ushqimit e parapara me dispozita ligjor të lartëcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përllogaritjen në atë mënyrë që, e ditët e kaluara në punë të paditësve, i ka shumëzuar me 2, duke i’au njohur shumat si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, me rastin e vendosjes ka marrë parasysh edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Sipas neneve të lartë cituara të Kontratë Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret, nga gjendja faktike e vërtetuar sipas kontratave të punës për paditësit, gjykatës i rezultojë së paditura është punëdhënëse e paditësve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorëve, përkatësisht këtu paditësve në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8 %, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur prej e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë.

Pasi që i autorizuari i paditësës në seancës e datës 12.05.2022, ka deklaruar se e tërheq padinë e paditësës M. K., dhe e paditura nuk e ka kundërshtuar tërheqjen e padisë, gjykata duke u bazuar në nenin 262 par.3 të LPK-së, vendosi si ne piken III te dispozitivit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën IV të dispozitivit, u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç ‘rast paditësve iu pranua shume e shpenzimeve në vlerë prej 591.60€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësorë në vlerë prej 30,00€(e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 156,00€, si dhe përfaqësimin e të autorizuarit të paditësve në dy seancë shumë prej 405.60 euro (202.80€x2) të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 7).

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 të LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.475/2021 datë 08 qershor 2022

Gj y q t a r j a,
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.